



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 823/7 prot.

Tiranë, më 12.06.2026

**VENDIM**

**Nr. 20, datë 12.06.2026**

**PËR KONTROLLUESIN SHOQËRIA “DITË E NATË” SHPK**

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit, si dhe provave të administruara në përfundim të hetimit administrativ në ngarkim të Kontrolluesit Shoqëria “Ditë e Natë” shpk (në vijim, “Kontrolluesi”),

**KONSTATOHET SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 60, datë 19.03.2026 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), ”), u krijua grupi i punës, i cili kreu hetimin administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të hetimit, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS M01417001E me objekt aktiviteti: “Tregtim medikamentesh, suplementesh, shtesash ushqimore, produkte kozmetike dhe medikal device me pakicë, etj.”

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e të dhënave “punonjës”, “pacientë”, “klientë”, “vizitorë”, etj. Përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi administron një sistem të dhënash të subjekteve nga blerjet online nëpërmjet website. Subjektet mund të bëjnë blerje online nëpërmjet krijimit të një llogarie me “Ditë e Natë” ose si “*guest*”. Kategoritë e të dhënave që përpunohen janë emri, mbiemri, adresa elektronike, numër kontakti, si dhe adresa e vendbanimit/vendqëndrimit, nëse zgjidhet që produkti të dërgohet në adresën e klientit. Nga verifikimi on-site i platformës së blerjeve online, konstatohet se të dhënat identifikuese të subjekteve të të dhënave administrohen pa përcaktuar një afat ruajtjeje, në kundërshtim me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 6 të Ligjit.

Gjithashtu, Kontrolluesi ka detyrimin të hartojë dhe zbatojë procedura të brendshme, të qarta dhe të dokumentuara, të cilat rregullojnë proceset e ruajtjes, fshirjes dhe asgjësimit të të dhënave personale, duke përcaktuar në mënyrë të saktë afatet e ruajtjes, kriteret për përfundimin e qëllimit të përpunimit, si dhe masat tekniko-organizative që garantojnë asgjësimin e sigurt të të dhënave në përputhje me kriteret ligjore.

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se Kontrolluesi disponon rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në përdorimin e sistemi të videosurvejimit (CCTV)*”, objekt i së cilës është përcaktimi i procedurave dhe masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, në kuadër të implementimit të sistemit CCTV për mbikëqyrjen e aktivitetit të ushtruar në ambientin e brendshëm dhe të jashtëm të punëdhënësit. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj, evidentohet se Kontrolluesi ka përcaktuar se të dhënat e mbajtura me anë të sistemit CCTV do ruhen për një periudhë deri në 2 (dy) muaj dhe pas kalimit të kësaj periudhe të dhënat do të fshihen. Gjithashtu, Kontrolluesi ka parashikuar se përpunimi i të dhënave personale me anë të sistemit CCTV do të realizohet për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në ligje të veçanta, si dhe Ligjin nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

Megjithatë, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga grupi i kontrollit nuk evidentohet dokumentacion provues lidhur me ruajtjen e pamjeve imazh/video në përputhje me procedurat përkatëse ligjore. Për rrjedhojë, ky konstatim vjen në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 30.04.2025, “*Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video survejimit*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video-survejjimit (CCTV). Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: “imazhe” e “video”, janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se periudha e mbajtjes së të dhënave nuk duhet të kalojë kufirin maksimal të afatit të lejuar, për përmbushjen e qëllimit të video-survejjimit. Të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të video-survejjimit duhet të ruhen për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë, dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar duhet të realizohet shkatërrimi i të dhënave imazhe/video, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe të Udhëzimit nr. 3. Nga ana tjetër, Kontrolluesi nuk arriti të provojë, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore, se ndodhet në një nga kushtet e parashikuara nga legjislacioni specifik dhe se ka ndjekur procedurën e përcaktuar lidhur me afatet e ruajtjes së pamjeve imazh/video nëpërmjet sistemit CCTV, me qëllim garantimin e ligjshëm të përpunimit të të dhënave personale sipas parashikimit në shkronjën “c” të pikës 2 të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit. Gjithashtu, Kontrolluesi nuk arriti të provojë, nëpërmjet dokumentacionit mbështetës ose evidencave teknike, se të dhënat e subjekteve të regjistruara nga sistemi i video-survejjimit CCTV janë shkatërruar/asgjësuar pas përfundimit të afatit të ruajtjes.

Nga verifikimi në vend i sistemit të video-survejjimit (CCTV), konstatohet se ky sistem regjistron imazhe dhe video të ambienteve të jashtme të përbashkëta publike, përfshirë trotualet dhe rrugën. Ky konstatim bie ndesh me parimet dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave personale, të përcaktuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit, si dhe në Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, të dhënat personale të ruajtura në sistemet CCTV duhet të përpunohen në përputhje me parimet e përpunimit të parashikuara në nenin 6 të Ligjit, si ligjshmëria, drejtësia dhe transparenca, kufizimi i qëllimit, minimizimi i të dhënave, saktësia, kufizimi i afatit të ruajtjes, integriteti dhe konfidencialiteti i të dhënave, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri. Në rastin konkret, vendosja e kamerave në ambientet e jashtme me mundësi regjistrimi rrugët dhe trotualet dhe fokusimin e qytetarëve, sjell përpunim të panevojshëm dhe të paligjshëm, pasi Kontrolluesi nuk ka arritur të provojë se mbështetet në një kriter të qartë ligjor, sipas parashikimeve të nenit 7 të Ligjit apo sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se mbikëqyrja e ambienteve të jashtme të Kontrolluesit, nëpërmjet sistemit të video-survejjimit CCTV, është në kundërshtim me parashikimet e neneve 6 dhe 7 të Ligjit.

4. Kontrolluesi ka krijuar në platformën “Instagram” profil zyrtar, në të cilin pasqyron veprimtari të ndryshme, duke ilustruar nëpërmjet fotografive dhe videove, të dhënat e subjekteve, “punonjës”, “pjesëmarrës”, etj.

Konstatohet se, të dhënat e subjekteve të të dhënave përpunohen/publikohen në rrjetin social “Instagram”, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret për përpunimin e të dhënave, të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit, si dhe pa marrë pëlqimin e tyre, sipas parashikimit të nenit 8 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, përmes publikimit të fotografive të subjekteve të të dhënave në platforma si “Instagram” apo të ngjashme, pa marrë paraprakisht “Pëlqimin”, bie në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të Ligjit.

Bazuar në nenin 8 të Ligjit, “Pëlqim” është çdo element tregues i vullnetit të subjektit të të dhënave, i dhënë lirisht, i informuar dhe i qartë, nëpërmjet të cilit ai, me anë të një deklaratë ose me çdo lloj shfaqjeje tjetër të padyshimtë pohuese të vullnetit, shpreh dakordësinë për përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të për një ose më shumë qëllime specifike.

5. Kontrolluesi ka publikuar “Politikat e Privatësisë” në faqen e internetit <https://www.ditenate.al/>, megjithatë nga analizimi i saj rezulton se subjektet e të dhënave nuk informohen qartësisht dhe në mënyrë të plotë për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, kategoritë e të dhënave personale, mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, faqja zyrtare e internetit përbën zakonisht pikën e parë të kontaktit ndërmjet Kontrolluesit dhe subjektit të të dhënave, ndaj mungesa e një politike mbi privatësinë ose publikimi i saj në mënyrë jo të qartë dhe të plotë kufizon informacionin e nevojshëm ndaj subjekteve mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale.

Gjithashtu, publikimi i rubrikës “Politikat e Privatësisë” në mënyrë të kuptueshme dhe të aksesueshme për subjektet e të dhënave është thelbësor për ushtrimin efektiv të të drejtave të tyre. Vetëm përmes informimit të plotë sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit, subjektet e të dhënave mund të njihen me të drejtat e tyre dhe me mënyrën për t’i ushtruar ato, duke shmangur situatat ku këto të drejta mbeten formale dhe të pazbatueshme në praktikë. Njëkohësisht, ato shërbejnë si mjet parandalues ndaj praktikave jo ligjore ose të njëanshme të Kontrolluesit gjatë përpunimit të të dhënave personale.

6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se, Kontrolluesi disponon një akt të brendshëm “*Procedurë për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, aksesin dhe sigurinë e të dhënave personale*”. Nga shqyrtimi dhe analizimi i përmbajtjes, rezulton se në të mungojnë parashikime mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, si mënyra e mbledhjes, regjistrimit, ruajtjes dhe asgjësimit të tyre, afatet konkrete të ruajtjes së të dhënave personale, etj., me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese që kryen, sipas parashikimeve të nenit 27 dhe 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përshtatja dhe plotësimi i aktit të brendshëm “*Procedurë për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, aksesin dhe sigurinë e të dhënave personale*”, me të gjithë elementët ligjorë të përcaktuar në pikën 1 të nenit 27 të Ligjit, konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit.

Gjithashtu, në aktin e brendshëm/rregullator duhet të përcaktohen në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura organizative për të gjitha aspektet e përpunimit të të dhënave, duke përfshirë, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë fizike, teknike dhe administrative, ruajtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave, aksesin, si dhe afatet e ruajtjes së të dhënave, me qëllim shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave personale.

7. Rezulton se, ndër të tjera, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale të subjekteve të të dhënave punonjës, vizitorë dhe klientë, nëpërmjet dosjeve fizike dhe në mënyrë elektronike (faqe e internetit, sistemi CCTV, etj.). Megjithatë, Kontrolluesi nuk ka vendosur në dispozicion dokumentacion provues lidhur me asgjësimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, për të cilat ka përfunduar qëllimi i përpunimit të tyre, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit.

Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ, rezulton se Kontrolluesi nuk ka hartuar procedura të qarta për fshirjen, asgjësimin ose anonimizimin e të dhënave personale pas përfundimit të afatit të ruajtjes (të dhënat për ish punonjës dhe klientë), si dhe mekanizma monitorimi dhe auditimi të brendshëm për të garantuar zbatimin efektiv të këtyre afateve, në kundërshtim me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit, si dhe Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “*Për përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 11*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të hartojë procedura të qarta për fshirjen, asgjësimin ose anonimizimin e të dhënave personale pas përfundimit të afatit të ruajtjes, si dhe mekanizma monitorimi dhe auditimi të brendshëm për të siguruar zbatimin e plotë dhe të dokumentuar të këtyre afateve. Në rastet kur të dhënat ruhen për periudha më të gjata për qëllime arkivore në interes publik, për qëllime kërkimore apo statistikore, duhet të aplikohen masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar minimizimin e të dhënave dhe kufizimin e aksesit, sipas parashikimeve

të nenit 45 të Ligjit. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 6 të Ligjit.

Gjithashtu, referuar nenit 27 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin të mbajë dokumentacion për veprimtaritë e tij përpunuese në mënyrë që të jetë në gjendje të japë të dhëna lidhur me përputhshmërinë me këtë ligj. Në këtë kuadër, mosdisponimi dhe mosdokumentimi i procedurave të brendshme rregullatore për asgjësimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, për të cilat ka përfunduar qëllimi i përpunimit të tyre, sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit, si dhe Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”, demonstroi mungesë të rregullimit të brendshëm për pajtueshmëri dhe mungesë të kapaciteteve organizative për garantimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së të dhënave personale.

8. Rezulton se, Kontrolluesi nuk ka marrë masat e duhura teknike dhe organizative për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, duke përfshirë, ndër të tjera, *pseudonimizimin dhe enkriptimin e të dhënave personale; aftësinë për të garantuar konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve dhe të shërbimeve të përpunimit; aftësinë për të rivendosur disponueshmërinë dhe aksesin në të dhënat personale brenda një kohe të arsyeshme në rast incidenti fizik ose teknik; një proces për testimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e rregullt të efikasitetit të masave teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e përpunimit, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” (në vijim, “Vendimi nr. 6”).*

Kontrolluesi, për shkak të veprimtarisë së tij, nuk ka marrë masa për të krijuar, zbatuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme një Sistem Menaxhimi të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System “PIMS”*), sipas Udhëzimit nr. 09, datë 20.11.2025 “Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale” (në vijim, “Udhëzimi nr. 09”).

Kuadri ligjor evropian mbi mbrojtjen e të dhënave personale, të cilin Ligji transponon, dhe praktika më e mirë evropiane, e konsideron certifikimin si një mekanizëm përputhshmërie me Ligjin dhe për të inkurajuar zbatimin e tij, i krijon rast pas rasti kontrolluesve që e zbatojnë atë në mënyrë efektive, një pozitë preferenciale në kryerjen e disa veprimtarive përpunuese të caktuara, siç janë për shembull transferimet ndërkombëtare. Në këtë kuadër, në zbatim të nenit 37 të Ligjit, i cili parashikon dhe rregullon mekanizmin e certifikimit, Komisioneri ka miratuar Udhëzimin nr. 08 datë 20.11.2025 “Për kriteret shtesë për akreditimin e organizimeve certifikues” (në vijim, “Udhëzimi nr. 08”) dhe Udhëzimin nr. 09.

Udhëzimi nr. 09 referon në Sistemet e Menaxhimit të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System "PIMS"*) dhe Komisioneri inkurajon kontrolluesit, të cilët për shkak të natyrës së veprimtarisë së tyre, e kanë të nevojshëm ngritjen e një sistemi të tillë me qëllim standardizimin dhe rregullimin e veprimtarisë përpunuese dhe garantimin e sigurisë së përpunimit të të dhënave personale, të zbatojnë Udhëzimin nr. 08 dhe nr. 09.

Në rastin konkret, Zyra e Komisionerit ka vlerësuar se, për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi duhet të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë një sistem menaxhimi të të dhënave personale (PIMS) në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 09.

Bazuar në nenin 28 të Ligjit dhe nenin 13 të Udhëzimit nr. 09, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete teknike dhe organizative që garantojnë nivel të përshtatshëm për rrezikun, masa të cilat duhet të rishikohen në mënyrë periodike për të siguruar efektivitet të vazhdueshëm.

9. Nga verifikimi on-site i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, si dhe nga shqyrtimi i procedurave rregulluese të Kontrolluesit, rezulton se:

- Kontrolluesi nuk ka hartuar dhe miratuar plane të dokumentuara për menaxhimin e riskut, përfshirë identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e rreziqeve që lidhen me përpunimin e të dhënave personale, si dhe nuk ka përcaktuar teknikat dhe mekanizmat përkatës të menaxhimit dhe monitorimit të performancës së masave të sigurisë, në kundërshtim me detyrimin për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm sipas parimit të llogaridhënies;
- Nuk ka të hartuar planin e politikave të vazhdueshmërisë së biznesit, dokumente këto që do të duhet të përmbanin politikat dhe objektivat që sigurojnë vijueshmërinë e punës;
- Nuk ka të specifikuar/dokumentuar kohën maksimale në të cilën shërbimet dhe sistemet nuk mund të jenë funksionale. Nuk janë planifikuar masa që në rast dështimi të një/disë pajisjeve të mos ndikohet në funksionimin e sistemeve dhe shërbimeve të ofruara;
- Nuk ka kryer auditime të brendshme me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të këtyre teknikave për menaxhimin e riskut (ose në mungesë të teknikave, identifikim të riskut);
- Politikat mbi gjurmët (log-et) për infrastrukturën mbështetëse TIK, nuk zbatohen sipas një procedure të rregulluar, me risk në qasje të paautorizuar në të dhëna, kërcënim të sigurisë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe mungesë transparence.

Gjithashtu, konstatohet se masat e ndërmarra në drejtim të backup-it janë të pamjaftueshme dhe nuk japin siguri në mbështetjen e planit të vazhdueshmërisë së

biznesit (BCP) dhe planit të rimëkëmbjes nga katastrofa (DRP), në kundërshtim kjo me masat e sigurisë së informacionit. Nuk u gjetën procedurat e rikrijimit (restore) të backup-it të të dhënave me qëllim testimin e tyre për t'u siguruar që ato janë të efektshme dhe që mund të ekzekutohen brenda kohës së lejuar. Këto procedura duhet të testohen rregullisht, sistematikisht dhe vazhdimisht.

Për sa më sipër, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht në këtë rast kur përpunimi i të dhënave kryhet nëpërmjet komunikimeve elektronike, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, mungesa e një plani të strukturuar për menaxhimin e riskut, e reflektuar në mos hartimin e procedurave për identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e rreziqeve, si dhe në mungesën e auditimeve të brendshme dhe monitorimit të vazhdueshëm të masave të sigurisë, cenon drejtpërdrejt parimin e llogaridhënies sipas nenit 6 dhe detyrimet e përcaktuara në nenin 28 të Ligjit. Pa një analizë të bazuar në risk, Kontrolluesi nuk është në gjendje të përcaktojë masa të përshtatshme teknike dhe organizative, duke krijuar ekspozim të lartë ndaj incidenteve të sigurisë, aksesit të paautorizuar dhe përpunimeve të paligjshme të të dhënave personale.

Në të njëjtën kohë, mungesa e planeve të vazhdueshmërisë së biznesit (BCP) dhe e planeve të rikuperimit nga katastrofat (DRP), si dhe mos përcaktimi i parametrave kritikë, si koha maksimale e ndërprerjes së shërbimeve (RTO/RPO), tregojnë një mungesë të planifikimit për garantimin e disponueshmërisë dhe integritetit të të dhënave. Këto mangësi rrisin ndjeshëm rrezikun që, në rast dështimi teknik apo incidenti kibernetik, të dhënat personale të mos rikuperohen brenda një afati të pranueshëm ose të humbasin në mënyrë të pakthyeshme, duke cenuar të drejtat dhe interesat e subjekteve të të dhënave.

Gjithashtu, mungesa e procedurave të rregulluara për administrimin e log-eve dhe pamjaftueshmëria e masave të backup-it, e shoqëruar me mungesën e testimin të rregullt të rikthimit të të dhënave (restore), tregon se masat e sigurisë janë të paplota dhe jo efektive në praktikë. Në këto kushte, Kontrolluesi nuk garanton gjurmueshmërinë e veprimeve mbi të dhënat, transparencën dhe aftësinë për të reaguar ndaj incidenteve, duke qenë në kundërshtim me kërkesat e nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit.

10. Konstatohet se, aktivitetet kryesore të Kontrolluesit janë procese përpunimi, të cilat, për shkak të natyrës, fushës së zbatimit ose qëllimeve të tyre, kërkojnë monitorim të rregullt e sistematik të subjekteve të të dhënave në një shkallë të gjerë. Kontrolluesi

nuk ka emëruar një nëpunës të mbrojtjes së të dhënave personale, në kundërshtim me nenin 33 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, aktivitetet e Kontrolluesit përfshijnë procese përpunimi të të dhënave personale që, për shkak të natyrës dhe mënyrës së realizimit të tyre, karakterizohen nga monitorim i vazhdueshëm i subjekteve të të dhënave. Konkretisht, përdorimi i sistemit të video-survejjimit (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të punës dhe hapësirave përreth, si dhe publikimi i vazhdueshëm i imazheve dhe videove në rrjetet sociale, që përfshijnë punonjës, klientë dhe persona të tretë, përbëjnë forma të përpunimit të cilat realizohen në mënyrë të strukturuar dhe të përsëritur në kohë.

Në këtë kuptim, këto procese përpunimi përbëjnë monitorim të rregullt dhe sistematik të subjekteve të të dhënave, pasi ato nuk janë të rastësishme apo sporadike, por pjesë integrale e ushtrimit të veprimtarisë së Kontrolluesit.

Në këto kushte, në përputhje me nenin 33 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për caktimin e një nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili do të sigurojë mbikëqyrjen e respektimit të legjislacionit në fuqi dhe përputhshmërinë e proceseve përpunuese me kërkesat ligjore. Bazuar në pikën 3, të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për të publikuar të dhënat e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, në mënyrë që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë atë, për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, sipas këtij ligji, si dhe për t'ia njoftuar ato Zyrës së Komisionerit.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të nenit 34 të Ligjit, i cili përcakton se nëpunësi caktohet në bazë të aftësive profesionale të certifikuara, Kontrolluesi ka detyrimin që të sigurojë trajnimin e nëpunësit të caktuar nga ana e tij në përputhje me pikën 6 të nenit 34 të Ligjit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare dhe në formë elektronike.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, është paraqitur në seancën dëgjimore, të datës 18.05.2026, të organizuar nga Zyra e Komisionerit, gjatë të cilës ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si dhe bashkëpunimin me Komisionerin për të siguruar që çdo mangësi të adresohet në përputhje me Ligjin.

Gjithashtu, nga ana e Kontrolluesit, me shkresën nr. 24 prot., datë 15.05.2026, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 823/5 prot., datë 15.05.2026, janë përcjellë parashtrimet lidhur me konstatimet e grupit të hetimit, si më poshtë:

- Lidhur me pikat 1 dhe 2, të Procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi pretendon se nga ana e tij është hartuar Rregullorja, ku në pikat 1-4 janë parashikuar masat e marra në zbatim të ligjit nr. 124/2024, për shkatërrimin e dokumentacionit dhe informacionit personal në përfundim të afatit ligjor. Në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, në veçanti Udhëzimin mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi dhe vendimin për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale, shoqëria kontrolluese ka hartuar dhe ka në fuqi kontratën e shërbimit për përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit CCTV.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Procesverbali i hetimit administrativ evidenton gjetjen/shkeljen sipas së cilës, Kontrolluesi nuk ka arritur të dokumentojë dhe provojë përmbushjen e këtij detyrimi. Procedurat e asgjësimit/fshirjes dhe anonimizimit përbëjnë një masë të rëndësishme sigurie, pasi ruajtja e panevojshme/në tejkalim të afateve që i shërbejnë qëllimit të përpunimit rrit rrezikun ndaj aksesit të paautorizuar, humbjes apo ekspozimit të panevojshëm. Në referim të pikës 7, të nenit 6, si dhe nenit 27 të Ligjit, nuk mjafton vetëm deklarimi nga ana e Kontrolluesit se ai i asgjëson/shkatërron të dhënat personale kur ato nuk janë më të nevojshme për qëllimin e përpunimit.

Kontrolluesi duhet të jetë në gjendje të provojë/dokumentojë në çdo kohë se disponon rregulla të brendshme, procedura organizative dhe evidenca që dëshmojnë se asgjësimi/shkatërrimi apo anonimizimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë të vazhdueshme, sistematike dhe të monitoruar. Në mungesë të procedurave/masave të dokumentuara, Kontrolluesi e ka të pamundur të vërtetojë/provojë përputhshmërinë e proceseve përpunuese me kërkesat e Ligjit.

Gjithashtu, këto procedura garantojnë ushtrimin efektiv edhe të të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, pasi në rastin e një kërkesë për fshirje apo kur lind detyrimi ligjor për t'i fshirë ato, Kontrolluesi duhet të ketë mekanizma të përcaktuar paraprakisht që mundësojnë identifikimin dhe fshirjen/asgjësimin e të dhënave personale nga të gjitha sistemet përkatëse që janë nën administrimin e Kontrolluesit.

Sa i përket kontratës së shërbimit për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit CCTV, Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Kjo shkelje nuk lidhet me proceset e deleguara të përpunimit, por me planvendosjen e kamerave CCTV. Fakti që administrimi teknik i sistemit CCTV kryhet nga një palë e tretë nuk e përjashton Kontrolluesin nga detyrimi për të siguruar që kamerat të jenë të pozicionuara në mënyrë të ligjshme dhe proporcionale me qëllimin e mbikëqyrjes, si

dhe që afatet e ruajtjes së pamjeve të jenë në përputhje me kufijtë e përcaktuar nga legjislacioni dhe aktet nënligjore përkatëse. Për rrjedhojë, çdo mospërputhje lidhur me orientimin e kamerave apo periudhën e ruajtjes së pamjeve video mbetet në sferën e përgjegjësisë së Kontrolluesit dhe nuk mund të justifikohet vetëm me ekzistencën e një kontrate shërbimi me një palë të tretë.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson se plani i vendosjes së kamerave CCTV duhet të mbështetet në një bazë ligjore të vlefshme, në përputhje me nenin 7 të Ligjit, si dhe të lidhet drejtpërdrejt me një qëllim specifik dhe legjitim për garantimin e sigurisë, dhe duhet të respektojë parimet e përcaktuara në nenin 6, në veçanti proporcionalitetin dhe minimizimin, duke kufizuar monitorimin vetëm në zonat e nevojshme.

- Lidhur me pikën 3 të Procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi pretendon se mbledhja e të dhënave personale dhe përdorimi i tyre në “Instagram”, kryhet nëpërmjet marrjes së pëlqimit paraprak nga punëmarrësi dhe gjithmonë të konfirmuar dhe të mirë informuar. Pamjet e tjera janë foto/video/imazhe të vendosura në dispozicion nga vetë kompania që tregton produktin e reklamuar. Në çdo rast, nuk ka pasur asnjë kërkesë lidhur me fshirjen e tyre apo heqjen e imazhit. Nëse ka ose do të ketë në të ardhmen, ai postim do të fshihet menjëherë brenda afateve ligjore, dhe jo më vonë se 30 ditë nga marrja e kërkesës.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Nga ana e Kontrolluesit, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në seancë dëgjimore, nuk është vendosur në dispozicion dokumentacion provues apo evidenca lidhur me marrjen e pëlqimit paraprak nga subjektet e të dhënave/punëmarrësit për publikimin e imazheve të tyre në platforma sociale.

Sa i përket pretendimit se nuk ka pasur kërkesa për fshirje, Zyra e Komisionerit vlerëson se mungesa e një kërkesë për fshirje/heqje të imazhit nuk përbën rrethanë përjashtuese për përgjegjësinë e Kontrolluesit lidhur me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale. Ligjshmëria e përpunimit vlerësohet në momentin e mbledhjes, përdorimit dhe publikimit të të dhënave personale dhe nuk kushtëzohet nga paraqitja ose jo e një kërkesë për fshirje nga subjektet e të dhënave.

Po ashtu, pretendimi se pamjet e publikuara “imazhe/video” të subjekteve të të dhënave janë përcjellë/vënë në dispozicion nga kompania që tregton produktin e reklamuar, nuk e përjashton Kontrolluesin nga përgjegjësia për të verifikuar ekzistencën e një baze ligjore për përpunimin/publikimin e të dhënave personale. Kontrolluesi nuk mund të mbështetet vetëm në deklarin se pamjet i përkasin produktit të reklamuar, por duhet të jetë në gjendje të demonstrojë se disponon dokumentacion të mjaftueshëm që provon ekzistencën e bazës ligjore për publikimin

e të dhënave personale. Në mungesë të një dokumentacioni të tillë, përgjegjësia për ligjshmërinë e përpunimit mbetet tek kontrolluesi që kryen publikimin.

- Lidhur me pikën 5, të Procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi në mënyrë të përmbledhur, parashtron se shoqëria përdor sisteme të certifikuara dhe zyrtare. Asnjë nga pajisjet nuk ka ndonjë program/aplikacion që nuk është zyrtar, i përditësuar dhe i protokolluar. Arkitektura e infrastrukturës TIK është projektuar sipas parimit të mbrojtjes në thellësi, me segmentim të rrjetit, firewall segmentation dhe monitorim të vazhdueshëm të trafikut. Lidhjet nga jashtë realizohen vetëm përmes VPN me autentifikim të shumëfishtë, shoqëria ka një sistem antivirus, përdoren VLAN-et për izolimin e rrjetit të brendshëm, etj. Për centralizimin e rrjetit dhe Domain Controller, kompania disponon dhe operon një Active Directory Domain Controller të plotë dhe funksional, çdo përdorues autentifikohet nëpërmjet Active Directory, etj. Lidhur me sigurinë perimetrale dhe mekanizmat IPS/IDS, kompania operon Fortinet FortiGate 201F, NGFW i klasës enterprise. FortiGate 201F ka aktive: IPS/IDS me bazë nënshkrimesh FortiGuard të përditësuar automatikisht, SSL/TLS Inspection, Application Control, Web Filtering, Anti Malware, etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e Kontrolluesit për përdorimin e sistemeve të certifikuara dhe arkitekturës së avancuar të sigurisë nuk qëndrojnë. Ato nuk provojnë në vetvete përputhshmërinë me kërkesat e neneve 27 dhe 28 të Ligjit. Përdorimi i pajisjeve “enterprise” si Fortinet FortiGate apo implementimi i mekanizmave si VPN, VLAN dhe Active Directory përbëjnë masa teknike standarde, por nuk dëshmojnë automatikisht efektivitetin real, konfigurimin korrekt dhe proporcionalitetin e tyre ndaj rreziqeve konkrete të përpunimit të të dhënave personale.

Gjithashtu, mungon provueshmëria mbi mënyrën e konfigurimit dhe menaxhimit të këtyre sistemeve (politika të dokumentuara të aksesit, auditime periodike, testime të penetrimit apo vlerësime të riskut), çka është thelbësore për të garantuar siguri reale dhe jo vetëm deklarative. Vetë fakti i ekzistencës së IPS/IDS apo filtrimit të trafikut nuk përjashton mundësinë e konfigurimeve të paplota, të paoptimizuara apo jo në përputhje me nenin 28 të Ligjit.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi nuk ka provuar që masat e deklaruara janë të dokumentuara, të testuara dhe të përshtatura me natyrën, qëllimin dhe rrezikun e përpunimit, duke mbetur kështu në nivel deklarativ dhe jo në përmbushje të plotë të detyrimeve ligjore për sigurinë e përpunimit.

Në përfundim u vlerësua se, shkeljet e konstatuara gjatë procesit të hetimit administrativ, të tilla si: mos dokumentimi i plotë për veprimtaritë përpunuese të Kontrolluesit në funksion të përputhshmërisë me Ligjin, mungesa e masave tekniko-organizative, si dhe mos caktimi i nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, në kuptim të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 94 të Ligjit, si dhe shkelja e parimeve dhe kritereve ligjore të

përpunimit të të dhënave personale, në kuptim të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 94 të Ligjit, si dhe mos zbatimi i detyrimit për transparencë dhe informim të plotë ndaj subjekteve të të dhënave, në kuptim të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 94 të Ligjit përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

*“1. Bazuar edhe në rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 1 000 000 000 (një miliard) lekë, ose në rastin e një shoqërie tregtare deri në 2% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado është më e lartë, shkeljet e detyrimeve:*

*a) të kontrolluesit dhe përpunuesit, sipas neneve 8, pika 6, e 11, të kapitullit III, të pjesës II të këtij ligji, me përjashtim të nenit 22 të këtij ligji;*

*2. Bazuar edhe në rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 2 000 000 000 (dy miliardë) lekë, ose në rastin e një shoqërie tregtare, deri në 4% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado që është më e lartë, shkeljet e mëposhtme:*

*a) moszbatimi i parimeve themelore të përpunimit, përfshirë kushtet për dhënien e pëlqimit, sipas neneve 6, 7, 8 e 9, të këtij ligji;*

*b) shkeljet e të drejtave të subjekteve të të dhënave sipas neneve 12-20 të këtij ligji.*

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nuk përmbush kërkesat e parashikuara nga Ligji dhe nuk mund të konsiderohet si provë e mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e masave të nevojshme organizative dhe teknike që Kontrolluesi ka detyrimin të zbatojë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rrjedhimisht, aktet e referuara nuk prodhojnë efekt juridik për qëllime të zbatimit të Ligjit.

Në rrethanat e shqyrtimit të kësaj çështje, Komisioneri evidenton shkallën e bashkëpunimit nga ana e Kontrolluesit. Gjithashtu, në llogaritjen e masës së sanksionit administrativ me gjobë, Komisioneri ka marrë në konsideratë xhiron vjetore të deklaruar nga Kontrolluesi, si dhe rëndësinë e proceseve përpunuese.

Sa më sipër, mbështetur në dispozitat e Udhëzimit nr. 06, datë 16.07.2025, “Për miratimin e metodologjisë për përlllogaritjen e masës së sanksioneve administrative”, veçanërisht në pikat 4 dhe 5, të Nënkapitullit 2.1 të Kapitullit 2 dhe të Kapitullit 4, Komisioneri ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe transparente masën e sanksionit administrativ ndaj Kontrolluesit, sipas përcaktimeve të neneve 93 dhe 94 të Ligjit, duke u bazuar në kufijtë minimalë të përlllogaritjes.

Komisioneri vlerëson faktin se, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe kritereve për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave personale. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

## PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 7, 8, 13, 27, 28, 33, 34, 81-84, pikës 1 të nenit 87, nenit 93, shkronjës “a” të pikës 1 dhe shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 94, si dhe nenit 95 të Ligjit, dhe të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Komisioneri,

## V E N D O S I:

1. Dënimin e Kontrolluesit Shoqëria “Ditë e Natë” shpk, me gjobë në masën **22,000,000** (njëzetë e dy milion) Lekë, për shkelje të neneve 6, 7, 8 dhe 13 të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit Shoqëria “Ditë e Natë” shpk, me gjobë në masën **9,090,000** (nëntë milion e nëntëdhjetë mijë) Lekë, për shkelje të neneve 27, 28 dhe 33 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, Shoqëria “Ditë e Natë” shpk, urdhërohet të marrë masa për përcaktimin e planeve të kamerave përmes sistemit të video-survejimit (CCTV), si dhe përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjithë proceset e përpunimit, në përputhje me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;
4. Kontrolluesi, Shoqëria “Ditë e Natë” shpk, urdhërohet të marrë masa për marrjen dhe administrimin e “Pëlqimit” të subjekteve të të dhënave në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 6, 7 dhe 8 të Ligjit;
5. Kontrolluesi, Shoqëria “Ditë e Natë” shpk, urdhërohet të marrë masa për përditësimin e rubrikës “Politikat e Privatësisë”, në faqen zyrtare [www.ditenate.com](http://www.ditenate.com), me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
6. Kontrolluesi, Shoqëria “Ditë e Natë” shpk, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, urdhërohet të marrë masa për përditësimin e aktit “Procedurë për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, aksesin dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar në të, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, përcaktimin e niveleve të aksesit, afatet e ruajtjes, etj.;
7. Kontrolluesi, Shoqëria “Ditë e Natë” shpk, urdhërohet të marrë masa për caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 34 të Ligjit, si dhe të njoftojë Zyrën e Komisionerit për caktimin e tij;

8. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, detyrimet sipas këtij akti duhet të përmbushen brenda afateve si vijon:

- (i) menjëherë detyrimet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të dispozitivit të këtij vendimi;
- (ii) vazhdimisht detyrimin e përcaktuar në pikën 5 të dispozitivit të këtij vendimi;
- (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve detyrimin e përcaktuar në pikën 6 të dispozitivit të këtij vendimi;
- (iv) brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 7 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

9. Kontrolluesi, Shoqëria “*Ditë e Natë*” shpk, duhet të njoftojë Komisionerin për masat e marra brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, duke filluar nga data e marrjes dijeni të këtij vendimi;

10. Vendimi për dënimin me gjobë përbën “titull ekzekutiv” dhe zbatohet nga kundërvajtësi (Kontrolluesi), brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e njoftimit. Për ekzekutimin e gjobës ngarkohet shërbimi përmbarimor gjyqësor;

11. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga data e njoftimit.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 12.06.2026.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**